

DORACAK ME RËNDËSI PËR FILLESTARËT NE KËRKIMIN E DITURISË

**Ligjëratat serike javore (të dielave pas namazit te Sabahut) NE LENDEN E
EDUKATES ISLAME për studentët e mi në Gjakovë, në Xhaminë e Honkes**

**Ligjërues & Perkthyes:
Hfz. Hajredin Hoxha**

Nga libri:

***Muhtasar Minhaxhul Kasidijn – Imam Ahmed bin Muhamed ibn Abdurahman
ibn Kudameh Al Makdisi***

Përmbledhës:

Shejh SHUAJB AL ARNAUTI & Shejh ABDYL KADËR ARNAUTI

(ALLAHU I MESHIROFTE)

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

1995-1996

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

PERMBAJTJA

- *Vlera e kërkimit të diturisë;*
- *Rëndësia e kërkimit të diturisë;*
- *Cilat dituri duhet të mësohen?*
- *Dituritë e lavdëruara dhe jo të lavdëruara;*
- *Edukata e nxënësit dhe e mësuesit (talebës dhe hoxhës);*
- *Obligimet e nxënësit ndaj mësuesit;*
- *Obligimet e mësuesit ndaj nxënësit;*
- *Dijetarët e mirë, dijetarët e këqij;*
- *Cilësitë e dijetarëve të mirë,*
- *cilësitë e dijetarëve të këqij;*
- *Dijetarët e kësaj jete, dijetarët e ahiretit)*

DY FJALE PER LEXUESIN E NDERUAR

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

Ne emer te Allahut, Meshirberesit dhe Meshiruesit

Te gjitha falenderimet dhe lavdatat i takojne vetem Allahut xh.sh. Salavatet tona me te perzemerta ia dergojme pejgamberit tone me te dashur Muhamedit alejhi selam, familjes se tij, shoqeve te tij dhe te gjithe atyre besimtareve Musliman qe e kan ndjek dhe e ndjekin rrugen e tij deri ne momentin e fundit te kesaj jete.

Student, talebe, hoxhe, hafez i nderuar, Allahu ju ruajte.

Ky doracak per kerkuesit e diturise ka qene nje nder punimet e mia te para qe kam filluar jeten time akademike pas diplomimit ne Medine Munevvere, nga fakulteti i Kur'anit dhe studimeve Islame ne vitin 1994. Jam shume i lumtur qe sot e prezantoj para jush ne websajtin tim te ri. Eshte punuar ky doracak para 25 viteve ne Gjakove me studentet e mi vullnetare qe vinin ne Xhamine e Honkes me mesue Kur'an dhe Edukate Islame. Ishte nje grup i studenteve te zgjuar dhe shembullor qe paten shpreh deshiren e tyre per ti mesuar bazat e Fese Islame me iniciativen e aktivistit fetar dhe dashamirit te fese Islame dhe te hoxhallareve po ashtu edhe tregtarit te njohur ne Gjakove dhe ne Kosove; Haxhi Abdullah Murati, te cilin e falenderoj me zemer dhe e lus Allahun xh.sh. me e shprblye me shperblimet me te mira ne kete jete dhe ne Ahiret, e se bashku me te ishte edhe bamirsi dhe aktivisti Haxhi Xhavit Koshi, Allahu i ruajte te dyte, dhe qe familjet dhe shtepite e tyre ishin shendruar ne mikpritje dhe respekt qe nuk harrohet kurre. Une i falenderoj ata dhe kur nuk do ti harroj, sepse kane qene shembull praktik te Islamit per mua qe vija nga Prizreni.

Perderisa isha Imam dhe Hatib e Mualim ne Xhamine e Sinan Katibit te Prizren, dhe profesor ne Medresen Alauddin-dega ne Prizren per lenden e Kur'anit, ishte shume veshtire per mua me gjete kohe te lire per t'i mesuar ata djem te rinj dashamiret e fese Islame nga Gjakova, keshtu qe dita e Diel ishte e vetmja dite qe kisha mundesine me prezentue pas namazit te Sabahut. E falsha namazin e Sabahut ne xhamine time dhe pastaj u niseshe per ne Gjakove, Vere e Dimer, pa pushim.

Atje fillova punen time sistematike te mesimit dhe te edukimit, dhe i zgjodha 5 lende qe te jipen aty ne xhami: **Lenda e Tefsirit**, nga libri *Ajatul Ahkam te sheikh Muhamed Ali Sabunit*. **Lenda e Edukates Islame** nga libri *Minhaxhul Kasidin te Imam ibn Kudemete el Makdisi*, – doracakut ne fjale - **Lenda e Texhvidit**, **Lenda e Kur'anit**, dhe **Lenda e Hadithit** nga libri i disa Doktorave nga Siria.

Elhamdulillah, keshtu vazhduam dy vite, dhe suktesi ishte i dukshem, qe edhe sot une krenohem me ata studenta te sinqerte qe ishin me drejtime dhe fakultete te ndryshme, e qe disa prej tyre edhe jane bere doktora shkence.

Normal per kete kontribut akademik tonin kemi hasur ne shume kritika dhe pengesa nga Keshilli i Bashkesise Islame i Gjakoves ne ate kohe, e qe ato kritika ishin pa vend dhe tendencioze.." hafiz Hajredini po hyn ne Gjakove nga dritarja e jo nga dera !!! etj etj" duke e harruar realitetin e kohes dhe te orarit te punes sime ne Prizren. Allahu ua falte.

Lus Allahun xh.sh. qe ky doracak te jete i hajrit dhe i bereqetit per te gjithe ata te cilet duan te studiojne fene islame.

Ves selamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu

Me respekt,


Prof.Dr.Hfz.Hajredin Hoxha

Doha –Qatar

01.09.2020

Libri në origjinal ndahet në katër pjesë:

1. Pjesa e parë: PARIMET E FESE (el ibadat)
2. Pjesa e dytë: ZAKONET (el adat)
3. Pjesa e tretë: DËNIMET (el muhlikat)
4. Pjesa e katërt: SHPËTIMET (el munxhijat)



Pjesa e parë: IBADETI

A) Dituria dhe vlera e saj.

Allahu xh.sh. thotë: “*Thuaj: A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?*” Me të vërtetë vetëm të Zotët e mendjes marrin mësim.” (Ez Zumer, ajeti 9)

“*Allahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri.*” (Muxhadele, ajeti 11)

“*Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët.*” (Fatir, ajeti 28).

Kurse Muhamedi (alejhi selam) ka thënë: “*Atij që Allahu (xhel-le-shanuhu) ia dëshiron të mirën, i mundëson ta mësojë sheriatin.*” (BUHARIU dhe MUSLIMI)

Nga EBU UMAME (sahib i Pejgamberit a.s.) transmetohet ky hadith: “*Para Muhamedit (alejhi selam) ishin përmendur dy burra, njëri prej tyre rob dhe i thjeshtë, kurse tjetri dijetar. Lidhur me këtë Muhamedi (alejhi selam) tha: “Vlera e dijetarit ndaj atij të thjeshtit është sikurse vlera ime ndaj më të thjeshtit nga ju. Pastaj Muhamedi (alejhi selam) në vazhdim tha: Me të vërtetë, melaiket, banorët e qiejve e të tokës, edhe buburreci në strofullin e vet, e edhe peshku në det, i luten Allahut (xhel-le-shanuhu) për ata që ua mësojnë njerëzve të mirën.*” (TIRMIDHIJ)

Muhamedi (alejhi selam) ka thënë: “*Vlera e dijetarit ndaj njeriut të thjeshtë është sikurse vlera hënës së plotë ndaj yjve të tjerë.*” Me të vërtetë, dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi pas vete, as dinarë e as dërrhem, mirëpo kanë lënë trashëgimi diturinë, e kush e trashëgon atë me të vërtetë ka marrë diçka të madhe (sepse dituria nuk matet me asgjë).

SAFVAN IBN ASAL transmeton se Muhamedi (alejhi selam) ka thënë: “*Melaiket e Allahut xh.sh. i shtrijnë krahët e tyre për atë i cili kërkon dituri.*”

Tek komenti i shtrirjes së krahëve, HATABIU thotë se janë tri mendime:

1. Shtrirja e krahëve të tyre për atë dhe shkelja mbi krah të melaikëve.
2. Melaiket i bëjnë nder dijetarit.
3. Melaiket e ndalin fluturimin e tyre dhe ulen bashkë me pjesëmarrësit në kuvendet ku shpjegohet dituria.

EBU HUREJRE¹ (r.a.) transmeton se Muhamedi (alejhi selam) ka thënë: “*Atij personi që ndjek një rrugë për të kërkuar dituri, Allahu (xhel-le-shanehu) ia lehtëson hyrjen në xhenet.*” (MUSLIMI)

¹EBU HUREJRE - emri i tij i vërtetë ka qenë ABDURRAHMAN IBN SAKHR, nga fisi Daus. E ka pranuar Islamit në vitin e shtatë hixhri dhe është njeri prej sahabëve më të shquar që ka transmetuar hadithe të Muhamedit a.s. E kanë

Nga SEHL IBN SADI transmetohet se Muhamedi (alejhi selam) i ka thënë ALIUT (r.a.): “O Ali! Të mundësojë Allahu (xhel-le-shanuhu) që nëpërmjet teje të udhëzohet një njeri në rrugë të drejtë, është më mirë për ty se krejt dynjaja.” (BUHARIU dhe MUSLIMI)

IBNI ABASI ka thënë: “Për atë, i cili ua mëson njerëzve të mirën, bën lutje tek Allahu (xhel-le-shanuhu) çdo gjallesë që është në fytyrë të tokës, e edhe delfini në det.”

-Nëse thuhet se në çfarë mënyre i lutet peshku ALLAHUT (xh.sh.) përgjigjja është: Dobia e diturisë e përfshin çdo gjë, e edhe peshkun në det.

Dijetarët, nëpërmjet diturisë, kanë treguar se çka është e mirë dhe çka është e keqe. Ata kanë porositur që të sillemi mirë ndaj çdokujt. Përveç kësaj, ata na kanë porositur që të sillemi mirë edhe ndaj kafshës që do ta presim. Allahu xh.sh. i ka inspiruar ata që t’i luten Allahut (xhel-le-shanuhu) për dijetarët, e ky është një shpërblim i madh për dijetarët.

EBU MUSA EL ESH'ARIU transmeton se ka qenë një hafëz, që ka pasur zë të bukur dhe Muhamedi (alejhi selam) shkonte shpesh për ta dëgjuar.

Muhamedi (alejhi selam) ka thënë: “Shembulli im me atë që më është shpallur mua nga Allahu (xhel-le-shanuhu) është sikurse shiu që bie në tokë. Një pjesë e tokës e thith ujin dhe në të mbijnë fryte.

Në anën tjetër, është një lloj toke tjetër që e ka thithur ujin, mirëpo nuk ka qenë frytdhënëse.

Po ashtu është edhe një lloj tjetër toke, e cila as nuk e thith ujin dhe as nuk është frytdhënëse.”²

HASAN EL BASRIU ka thënë: Po të mos kishin ekzistuar dijetarët, njerëzit do të kishin qenë si kafshët.

HAZRETI KAB (r.a.) ka thënë: Allahu (xhel-le-shanuhu) i ka shpallur MUSËS (a.s.): “O Musa! Mësohu vetë dhe mësoi të tjerët, se unë kam për t’i ndriçuar varret e atyre që ua mësojnë të mirën të tjerëve.”

pyetur: -Si i ke mësuar këto hadithe? Është përgjigjur: -Ju jeni hutuar mbas tregtisë në pazar, ndërsa unë jam angazhuar mbas Pejgamberit (alejhi selam).

² Shembulli i parë komentohet se e ka dëgjuar fjalën e Allahut xh.sh. dhe ju ka treguar të tjerëve. Shembulli i dytë: e ka dëgjuar fjalën e Allahut, mirëpo nuk ju ka treguar të tjerëve. Shembulli i tretë: as nuk e ka dëgjuar fjalën e Allahut xh.sh., e as nuk ju ka treguar të tjerëve. (BUHARIU dhe MUSLIMI)

KËRKIMI I DITURISË ËSHTË OBLIGIM

Nga ENES IBN MALIKU³ (r.a.) transmetohet se Muhamedi (alejhi selam) ka thënë:
“Kërkimi i diturisë është farz (obligim) për çdo musliman.”

DIJETARËT ISLAMË KANË DHËNË DISA MENDIME PËR DITURITË QË DUHET TË MËSOHEN

1. Fukahatë kanë thënë se dituria që duhet të mësohet është fikhu, sepse nëpërmjet fikhut dihet çka është hallall e çka haram.
2. Mufesirët dhe muhadithinët kanë thënë se dituria që duhet të mësohet ka të bëjë me Kur’anin dhe Muhamedin (alejhis selam).
3. Dijetarët sufistë kanë thënë se dituria në fjalë nënkupton diturinë e sinqeritetit dhe dobësive të (zemrës së) njeriut.
3. Dijetarët e akaidit kanë thënë se këtu është për qëllim ILMU KELAMI – mësim besimi në ALLAHUN xheleshanuhu.

³ Dy fjalë për Enesin: Enesi (radi Allahu anhu) thotë se i ka shërbyer Muhamedit (alejhi selam) dhjetë vite dhe se ai nuk e ka kritikuar asnjëherë për ndonjë gjë. Muhamedi (alejhi selam) i është lutur Allahut (xhel-le shanuhu) që t’ia zgjasë jetën Enesit, ta pasurojë dhe t’i japë fëmijë. Dhe në të vërtetë Allahu (xhel-le shanuhu) i është përgjigjur lutjes së Muhamedit (alejhi selam). Kopshtet e Enesit kanë dhënë dy herë fryte në vit. Ai ka qenë sahabiu që ka pasur më së shumti nipa se çdokush tjetër dhe ka jetuar më së shumti nga të gjithë sahabët e Muhamedit (alejhi selam).

DIJETARËT ISLAMË I KANË NDARË OBLIGIMET NË DY GRUPE:

1. Farzi Ajn – Obligimi personal
2. Farzi Kifaje – Obligim shoqëror

FARZI AJN: Është ai farz të cilin duhet ta zbatojë patjetër çdo musliman, p.sh.: theksimi i shehadetit, falja e namazit, agjërimi i ramazanit, zeqati dhe haxhi (kush ka mundësi).

FARZI KIFAJE: Është ai farz i cili bartet si detyrë mbi tërë bashkësinë muslimane. Nëse një grup e kryen atë punë, të tjerët lirohen, p.sh.: mësimi i medicinës, matematikës, falja e namazit të xhenazes, xhihadi për mbrojtjen e atdheut etj.

Në Islam disa dituri janë të lavdëruara e disa të urryera, p.sh. lavdërohet mësimi i historisë, biologjisë etj., ndërsa urrehet mësimi i sehireve dhe i çdo gjëje që është në dëm të shoqërisë.

DITURIA E SHERIATIT NDAHET NË DY GRUPE:

1. EL USUL – BAZAT E SHERIATIT – dituria rreth Kur'anit dhe Hadithit (fjalëve të Muhamedit alejhi selam).

2. EL FURU'E – DEGËZIMET, sikurse edhe mësimi i Nahvit – Sintaksës. Këto konsiderohen metodat për të kuptuar Kur'anin dhe Hadithin. Në përgjithësi, dituritë e sheriatit, me të gjitha degëzimet e tij, janë të lavdëruara tek Allahu xhel-le-shanuhu (EL ULUM EL MAHMUDETU).

Zemra e muslimanit duhet të ketë frikë vetëm ndaj Allahut (xhel-le-shanuhu), duhet t'i lutet vetëm Atij, duhet të jetë i kënaqur me caktimin e Tij, duhet të jetë e mbushur me drejtësi dhe sinqeritet etj.

Prej dijetarëve islamë, që i kanë poseduar këto cilësi, mund të përmendim: SUFJAN ETH - THEURIUN, IMAM EBU HANIFEN, SHAFIUN, MALIKIUN, AHMEDIN etj.

Disa dijetarë islamë, kur flasin për ligjet e sheriatit, trajtojnë në përgjithësi disa probleme që ndodhin rrallë, si p.sh. shkukurëzimi, mirazi etj. Ata iu kushtojnë më shumë rëndësi këtyre problemeve, e kur vjen puna te sinqeriteti i muslimanit ndaj caktimit të Allahut xhel-le-shanuhu dhe te ruajtja ndaj formalitetit, ata flasin pak për këto probleme të rëndësishme.

IMAM HASAN EL BASRIU thotë: “I mençur është ai i cili nuk e lidh zemrën e tij me këtë dynja (jetë), por synon ahiretin, e ruan fenë e tij, është i saktë në ibadete, e ruan gjuhën e tij nga cenimi i nderit të muslimanëve, nuk lakmon pasurinë e të tjerëve dhe i këshillon të tjerët për të mirë.”

DITURITË E LAVDËRUARA

Dituritë e lavdëruara ndahen në dy grupe:

1. DITURIA tepër e lavdëruar – është ajo dituri e cila ka të bëjë me qenësinë e Allahut (xhel-le-shanuhu), me cilësitë dhe me punët e Tij. Këtë dituri duhet ta kërkojë secili, sepse nëpërmjet kësaj diturie ai fiton kënaqësinë e ahiretit. Kjo dituri është një det i pafundmë, të cilit nuk kemi mundësi t'i dalim në skaj, mirëpo secilit duhet t'i mësojmë sa t'ia bëjë nasib Allahu (xhel-le-shanuhu).

2. DITURIA e lavdëruar pjesërisht – është ajo dituri e cila i përket farzit kifaje, prandaj bëhuni njëri prej dy personave: ose ndihmoje veten tënde ose ndihmoji tjetërkujt, mbasi e ke kryer punën tënde. Mjerë për ty të punosh për tjetërkënd pa përmirësuar veten tënde. Mundohu që, së pari, ta përmirësosh dhe ta pastrosh brendinë tënde nga cilësitë e urryera, si: zilia (HASEDI), formaliteti (RIJA), mendjemadhësia (KIBRI), syri i pangopur lakmitar (El HISR) etj. Nuk bën ta zbatojmë farzin kifaje pa i kryer obligimet e lartpërmendura AJN, sepse është çmenduri ta përmirësosh tjetërkënd dhe ta lësh pa pastruar veten tënde,

sikurse p.sh. një njeri që i janë futur akrepat dhe insektet në rrobat e tij dhe ai mundohet t'ia largojë mizat tjetërkujt.

Së pari duhet të fillosh me librin e Allahut (xhel-le-shanuhu), mandej me sunetin e Muhamedit (alejhi selam), pastaj me dituritë rreth Kur'anit (Tefsir), më pas me Texhvidin. Po ashtu, duhet të vazhdosh me termat e posaçëm: MUHKEM dhe MUTESHABI – ajetet e qarta dhe të paqarta, NASIH dhe MENSUH – anulues dhe i anuluar, ES BAB EN NUZUL – shkaqet e zbritjes së ajeteve. Më pas duhet të vazhdosh me njohuritë rreth sunetit MUSTALAHU EL HADITH – Terminologjia rreth hadithit.

Mundi nuk duhet të shpenzohet veç në një drejtim, sepse dituria është e madhe, kurse jeta është e shkurtër. Dituritë që i përmendëm janë mjete ndihmëse për një qëllim më të lartë, e ky qëllim është kënaqësia e Allahut (xhel-le-shanuhu).

DIJETARI QË NUK E SHEH DOBINË E DIJES SË VET

Duhet ta kesh gjithmonë parasysh se çdo polemikë apo dialog, që bëhet me qëllimin e mburrjes apo mendjemadhësisë, është burim kryesor për vetitë e këqija. Zemra e personit të këtij lloji është shumë vështirë që të shpëtojë nga KIBRI.

Për çfarë arsye? Për shkak se qëllimi i tij është që ta mposhtë kundërshtarit. Ai mendon për veten e tij se kinse po di diçka. Por zemra e tij është shumë vështirë të shpëtojë nga RIJA (formaliteti), sepse shumica e atyre që bëjnë dialog me shokët e tyre kanë për qëllim që të tregojnë se fituan dhe i mposhtën të tjerët, dhe nuk synojnë që të tregohet e vërteta – *haku*. Ata kanë për qëllim që të lavdërohen prej njerëzve kur korrin sukses ndaj kundërshtarit. Ata e shkrijnë jetën e tyre për disa çështje të çuditshme, vetëm për të dialoguar me shokët e tyre se kinse dinë diçka, e jo për të mësuar diturinë e ahiretit.

EDUKATA E NXËNËSIT DHE E MËSUESIT

(TALEBES DHE HOXHËS)

Edukata e nxënësit

Nxënësi duhet ta pastrojë shpirtin dhe zemrën e tij nga vetitë e këqija, sepse dituria është ibadet i zemrës.

Ai duhet të largohet nga punët që e hutojnë dhe e shmangin nga qëllimi kryesor, sepse mendja, kur hutohet, nuk mund ta arrijë të vërtetën.

Dijetarët e hershëm (SELEFUS-SALIH) e kanë pasur traditë që t'i japin rëndësi diturisë më shumë se çdo gjëje tjetër.

Nga IMAM AHMED IBN HANBELI transmetohet se ai, për shkak të diturisë, e ka vonuar martesën deri në moshën dyzetvjeçare.

Nga EBU BEKER EL ENBARI transmetohet se dikush i kishte dhuruar një robëreshë. Kur desh të kishte kontakt me robëreshën, atij ju kujtua një mesele (dituri) e fesë. U largua nga ajo dhe bërtiti: "Nxirreni shpejt jashtë këtë robëreshë". Anëtarët e familjes e pyetën se çfarë kishte bërë ajo. Ai u përgjigj se ajo nuk kishte bërë gjë, mirëpo zemra dhe koka e tij ishte hutuar nga ajo robëreshë. Pastaj ai i tha robëreshës: "Si mundet që diçka e pavlefshme si ti, të krahasohet me atë që është më e vlefshme (në këtë rast me diturinë)?!"

Nxënësi duhet që t'ia dorëzojë çështjen e tij (qenien e tij) mësuesit të tij (hoxhës), ashtu sikurse i sëmuri që ia dorëzon çështjen e tij mjekut. Po ashtu, ai duhet të jetë i thjeshtë para tij, e jo mendjemadh.

IBNI ABASI (radiallahu anhu) e ndihmonte gjithmonë ZEJD IBN THABITIN që të hipte në kalin e tij dhe thoshte: "Kështu jemi urdhëruar që të veprojmë me dijetarët."

Në atë moment që nxënësi bëhet mendjemadh para hoxhës (mësuesit) dhe nuk dëshiron të përfitojë nga dituria e tij, ai është xhahil, sepse mençuria (hikmeti) është thesar i humbur i besimtarit, të cilën ai duhet ta marrë kudo që ta gjejë. Ai duhet të heqë dorë nga mendimi i tij dhe t'i bashkëngjitet mendimit të hoxhës së tij, sepse në disa raste mendimi i hoxhës së tij është më i qëlluar se sa mendimi i nxënësit (i cili mendon se hoxha ka gabuar).

HAZRETI ALIU (radiallahu anhu) thotë: "Prej të drejtave që ka hoxha ndaj nxënësit është që, mbasi t'i japë selam:

-Ta përshëndesë personalisht atë dhe të ulet përballë tij.

-Mos ta përshëndetë dikë tjetër me dorë para tij.

-Mos t'ia mbyll syrin dikujt tjetër para tij.

-Mos të bëjë pyetje të tepërta para tij.

-Mos t'i ndihmojë atij në përgjigje.

-Kur hoxha dëshiron ta ndërpresë ligjëratën, dersin apo ibadetin, të mos ndërhyjë e t'i thotë: -Çka po bëjmë tani, o hoxhë, çfarë po na shpjegon?

-Kur hoxha ta ndërpresë përgjigjen, nuk bën ta detyrojë ta përsërisë përgjigjen.

-Kur hoxha dëshiron të shkojë, nuk duhet ta tërheqë për tesha dhe ta ndalë.

- Të mos i përhapë sekretet e tij.
- Të mos bëjë përgojim (GIBET) para tij.
- Të mos mundohet ta zërë ngushtë hoxhën e tij.
- Nëse hoxha gabon rastësisht, ai duhet t'ia pranojë arsyet e gabimit.
- Mos të thotë para hoxhës se një hoxhë tjetër po thotë një mendim tjetër.
- Mos t'i thotë se dikush tjetër është kundër tij.
- Mos ta madhëroje para hoxhës një dijetar tjetër, por edhe mos ta nënçmojë.
- Shoqërimi i gjatë me hoxhën të mos të jetë shkak që të largohet prej tij.
- Të mos bëhet mendjemadh e të mos i shërbejë hoxhës (t'i ndihmojë kur ka mundësi).
- Në rast se ekziston nevoja për ndihmë, të mundohet të jetë më i pari ndër të gjithë.

SHEMBULLI i dijetarit është sikurse trupi i hurmës së pjekur: presim të bien kokrrat prej saj dhe vërsulemi që t'i rrëmbejmë ato.

Duhet pasur kujdes që nxënësi të mos iu kushtojë rëndësi mospajtimeve me të tjerët (atyre për të cilat njerëzit kundërshtohen ndërmjet vete, sepse kjo ia huton mendjen), por duhet që t'iu kushtojë rëndësi diturive më kryesore, sepse jeta nuk mjafton për të gjitha dituritë.

OBLIGIMET E MËSUESIT (HOXHËS) NDAJ NXËNËSIT (TALEBES)

Mësuesi duhet të ketë mëshirë të madhe ndaj nxënësve dhe duhet t'i konsiderojë ata si fëmijët e tij. Ai nuk duhet të kërkojë shpërblim për përhapjen e diturisë dhe as mirënjohje dhe falënderim, por duhet ta ketë njetin për All-llahun xh.sh. Po ashtu, mësuesi nuk duhet ta konsiderojë veten më të lartë se nxënësit, por duhet t'i konsiderojë ata më të mirë dhe më të lartë se vetë ai, për arsye se ata i kanë përgatitur zemrat e tyre për All-llahun xh.sh. Shembulli është sikurse ai i cili ia huazon tokën për të mbjellë dikush diçka (pra duhet të gëzohemi që dikush kërkon diturinë për All-llah).

Mësuesi duhet ta kërkojë shpërblimin tek All-llahu xh.sh., e jo prej të tjerëve. Dijetarët e hershëm (SELEFUSALIH) nuk kanë pranuar asnjëherë dhurata prej nxënësve të tyre.

Sa i përket shpërblimit të mësuesit (hoxhës), myezinit, ligjëruesit javor, pastruesit dhe hatibit, dijetarët e hershëm të mejtepit hanefi kanë qenë të mendimit se këtyre nuk iu takon shpërblimi dhe nuk iu takon paga, mirëpo dijetarët e mëvonshëm, për shkak të vështirësive ekonomike, e kanë parë të arsyeshme që të jepet një shpërblim i posaçëm për ligjëruesin, për pastruesin etj., nga fondi apo buxheti i bashkësisë muslimane. Ata janë bazuar dhe kanë pasur si argument faktin se EBU BEKRI ju ka dhënë shpërblim (paga) disa punëtorëve dhe, përveç kësaj, edhe ua ka shtuar atyre pagat.

Mësuesit nuk i lejohet që të jetë i rezervuar ndaj nxënësit të tij. Nëse nxënësi devijon ose priset moralisht, mësuesi duhet ta këshillojë atë në mënyrë alegorike e jo të drejtpërdrejtë (indirekt e jo direkt) dhe jo në mënyrë ofenduese, sepse ofendimi e rrëzon perden e autoritetit. Po ashtu, mësuesi duhet ta ketë parasysh aftësinë logjike të nxënësit dhe nuk duhet ta ngarkojë me ato gjëra që mendja e tij nuk mund t'i kuptojë.

Transmetohet se Muhamedi (a.s.) ka thënë: *“Jam urdhëruar që t’ju flas njerëzve sipas asaj që ata e kuptojnë.”*

Po ashtu, mësuesi duhet të punojë vetë në përputhje me diturinë e tij, në mënyrë që fjalët e tij të mos kundërshtohen me veprat e veta.

“A PO I UDHËZONI TË TJERËT ME MIRËSI E VETEN PO E HARRONI? DHE JU PO E LEXONI LIBRIN. A NUK LOGJIKONI SE SI VEPRONI? (EL BEKARE 44)

H. ALIU (r. a.) ka thënë: Dy persona më kanë munduar shumë:

-Një dijetar (Alim) që vepron në kundërshtim me atë që flet dhe di.

-Një xhahil që i bën shumë ibadet All-llahut (xh. sh.)

DIJETARËT E KËSAJ BOTE DHE TË AHIRETIT

Dijetarët e këqij janë ata të cilët e përvetësojnë diturinë me qëllim që të kënaqen dhe të dëfrenjë në këtë jetë dhe që, nëpërmjet asaj diturie, synojnë të arrijnë në një pozitë të lartë.

Nga Ebu Hurerje transmetohet se Muhammedi (alejhi selam) ka thënë:

“Ai i cili mëson një dituri me qëllim që të arrijë diçka në këtë jetë, e jo për hir të All-llahut (xh. sh.), nuk ka për ta shijuar erën e xhenetit e lëre më të hyjë në të”. (TIRMIDHIU)

Muhammedi alejhi selam ka thënë:

“Ai i cili e mëson një dituri për t’u krenuar para dijetarëve ose për t’u futur në dialog me injorantët (xhahilat) ose për të tërhequr vëmendjen të tjerëve se kush është ai, me të vërtetë ai është në zjarr”. (TIRMIDHIU)

Disa dijetarë të hershëm kanë thënë se më së shumti që pendohet dhe dëshpërohet para vdekjes është ai dijetar i cili nuk ka punuar sipas fjalëve të Muhammedit (alejhi selam).

Po ashtu duhet të dimë se dijetari duhet t’i respektojë ligjet e All-llahut xh. sh., qofshin ndalesa apo urdhëresa, dhe nuk duhet të largohet dhe të heqë dorë nga gjërat e lejuara (për t’u bërë Zahid). Ai duhet t’iu kushtojë sa më pak rëndësi pasurive të kësaj jete. SUFJAN ETHERIU (All-llahu e mëshiroftë) transmeton se ai është ushqyer mirë gjithë jetën, pasi -siç thotë ai - nëse kafshës nuk i jep të hajë, ajo nuk punon mirë.

DISA CILËSI TË DIJETARËVE TË AHIRETIT

Të gjithë duhet ta dinë se kjo jetë është e pavlefshme, kurse ahireti është i shtrenjtë dhe i vlefshëm. Dynjaja dhe ahireti janë si dy ortakë, mirëpo dijetarët i japin përparësi ahiretit.

Punët dhe veprat e tyre nuk janë në kundërshtim me fjalët e tyre. Ata i kushtojnë shumë rëndësi diturive të vlefshme, të cilave kanë për t’ua parë hairin në ahiret dhe largohen nga ato dituri, dobia e të cilave është e vogël.

Nga SHEKIK EL BELEHI (All-llahu e mëshiroftë) transmetohet se ai i ka thënë Hatimit: “Je shoqëruar me mua për një kohë të gjatë. Çfarë ke mësuar prej meje?” Ai i ka thënë: “Kam mësuar tetë dobi (dituri) të rëndësishme.

DOBIA E PARË - Unë shikova krijesat e All-llahut xh. sh. (njerëzit) dhe pashë se çdo njeri ka një të dashur, mirëpo ky i dashuri, kur ta përcjellë në varr, largohet nga ai. Për të dashur më të madh i kam konsideruar veprat e mia të mira, kështu që të mos mbes në varr në vetmi.

DOBIA E DYTË - Kam vërejtur se shumica e njerëzve shkojnë pas epshit të tyre dhe mundohen t'i kënaqin dëshirat e veta. Në atë situatë unë kam kujtuar fjalën e All-llahut (xh. sh.) që thotë: *"Kush i frikësohet All-llahut dhe e ndalon veten prej epsheve, vendi i tij është në xhenet."* (Naziat, 40)

Atëherë kam shpejtuar t'i kundërvihem epshit tim dhe të zhvilloj luftë të vërtetë kundër tij, ashtu që të bindet dhe të jetë i nënshtruar ndaj All-llahut xh.sh.

DOBIA E TRETË - Kam vërejtur se si njerëzit garojnë për të grumbulluar pasuri dhe për ta ruajtur atë, mirëpo unë mendova ajetin kur'anor ku All-llahu (xh.sh.) thotë: *"Çka është tek ju është kalimtare dhe zhduket, kurse çka është tek All-llahu mbetet përgjithmonë."* (Kur'an, Surja En Nahl, 96) Atëherë kam vendosur që tërë pasurinë t'ua ndaj të varfërve, kështu që të kem rezerva tek All-llahu xh. sh.

DOBIA E KATËRT - Kam vërejtur tek njerëzit se ata i kushtojnë rëndësi krenarisë, pasurisë dhe nderit. E unë mendova për fjalën e All-llahut (xh. sh.) që thotë: *"Më i ndershmi tek unë është ai i cili është më i devotshmi, më besimtari, më parimori"*. (Surja El Hujurat, ajeti13) Atëherë unë mendova që të jem më i devotshmi, kështu që të bëhem më i ndershmi.

DOBIA E PESTË - Kam vërejtur tek njerëzit se ata sulmojnë, grinden dhe shpifin për njëri-tjetrin. E tërë kjo ndodh nga xhelozia për shkak të pasurisë dhe pozitës. E unë u ndala dhe vështrova ajetin kur'anor, ku All-llahu xh. sh. thotë: *"Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë. Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se të tjerët në shërbime."* (Zuhruf, ajeti 32) Atëherë e kam lënë xhelozinë.

DOBIA E GJASHTË - Kam vërejtur tek njerëzit se ata e urrejnë njëri-tjetrin dhe janë armiq të njëri-tjetrit, mirëpo mendova për ajetin kur'anor ku All-llahu (xh.sh.) thotë: *"Se me të vërtetë shejtani është armiku juaj dhe si armik duhet ta konsideroni."* (Surja Fatir, ajeti: 6) Nga ky ajet kuptova se vetëm shejtani duhet të urrehet dhe duhet të konsiderohet si armik.

DOBIA E SHTATË - Kam vërejtur tek njerëzit se ata mundohen, poshtërohen dhe e humbin dinjitetin e tyre për grumbullimin e pasurisë, ndërsa All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: *"Në tokë nuk ka asnjë qenie të gjallë që mos ta ketë ushqimin tek All-llahu."* (Hud, 6).

Kështu që jam bindur se All-llahu (xh. sh.) është garancia më e madhe për furnizimin tim dhe nuk ka nevojë që të poshtërohem dhe ta humb nderin tim për grumbullimin e pasurisë.

DOBIA E TETË - Kam vërejtur tek njerëzit se gjithkush mbështetet në diçka, dikush në pasuri, dikush në pozitë, dikush në shëndet. E sa më përket mua

unë mbështetem tek All-llahu (xh.sh.) i Cili në Kur'an thotë: "*Atij mbështetjuni nëse jeni besimtarë.*" (Maide, ajeti :23).

CILËSITË E ULEMAVE TË AHIRETIT

Prej cilësive të dijetarëve të ahiretit mund të veçojmë:

1. Ata nuk përzihen me kryetarët apo me njerëzit që janë në pozitë. HUDHEJFE (r.a.) ka thënë: “Kini kujdes nga vendet e fitnes, përçarjes dhe provokimeve të ndryshme. Të tjerët i thanë: ‘Çka është fitnja – cilat janë vendet e provokimit?’ Ai tha: ‘Fitne janë dyert e njerëzve të cilët janë në pozita të larta (kryetarët). Dikush prej jush futet te princi (funksionari) dhe ia vërteton gënjeshtren e tij dhe thotë ato që ai nuk i meriton.’”

SAID IBNUL MUSJIB (r.a.) ka thënë: “Po të shihni një dijetar (hoxhë) që po sillet shumë nga dyert e princave, kini kujdes nga ai se është hajn.”

Dijetarët e hershëm kanë thënë: “Nëse ti merr nga dynjaja (pasuria) e tyre diçka, ata kanë për të marrë prej fesë tënde më shumë.

2. Ata nuk nguten në dhënien e fetvave dhe, nëse japin fetva, e japin saktësisht. Ka qenë traditë e dijetarëve të hershëm, që kur u ka ardhur dikush për të kërkuar përgjigje (fetva), ata i kanë dhënë përparësi tjetrit, kështu që pyetësi është detyruar të kthehet tek i pari ku ka kërkuar përgjigje. Prej sinqeritetit dhe frikës që kishin nga All-llahu xh.sh., të tjerët nuk u përgjigjeshin pyetjeve edhe pse i dinin përgjigjet.

ABDURRAHMAN IBN EBI LEJLA (r.a.) ka thënë: “Kam pas rastin që në këtë xhami (Xhamia e Muhammedit a.s.) të mbërrijnë 120 as’habë të Muhammedit a.s. Kur vinte dikush për t’i pyetur për diçka, secili prej tyre kishte dëshirë që pyetjes t’i përgjigjej ai tjetri.

Më pas çështja ka mbërritur deri aty, saqë disa persona, që e konsiderojnë veten të dijshtëm, nxitojnë t’iu përgjigjen pyetjeve, të cilat nëse do t’i ishin parashtruar hazreti Ymerit, ai nuk kishte për t’iu dhënë përgjigje, pa i mbledhur sahabët e luftës së Bedrit (të cilët e kanë përjetuar luftën) dhe pa u konsultuar me ta.

3. Ata i kushtojnë rëndësi sinqeritetit të veprave, kujdesen për pastrimin e zemrave të tyre nga mendimet e këqija, nga dyshimet etj. Si bazë e fesë është ruajtja nga dëmi. E personi nuk mund të ruhet saktësisht pa e ditur se çka është dëmi. Njëri prej dijetarëve ka thënë: “E kam mësuar dëmin jo për ta punuar atë, por që të ruhem nga ai.” Ai i cili nuk e di dëmin, ai edhe bie në të dhe vepron sipas tij.

4. Janë munduar të kuptojnë disa fshehtësi të ligjeve kur'anore me qëllim që t’ju shtohet besimi, mirëpo nëse nuk i kanë kuptuar, atëherë janë dorëzuar tek All-llahu xh. sh.

5. Kanë pasur për shembull (për mostër) sahabët e Pejgamberit a.s. dhe të zgjedhurit e tabiinëve dhe janë ruajtur nga çdo shpikës i ri në fe.

Allahu e di më mirë!

Kete liber madheshtor e kemi pas tekst shkollor ne lenden e Edukates Islame ne Damask te Sirise me 1983-1989.

Rekomandoj fuqishem qe libri komplet te perkthehet ne gjuhen shqipe per hir te Allahut dhe studenteve te rinj qe jane qasur rruges se diturise.

Ky liber eshte permbledhje e librit enciklopedik Ihjau Ulumid Din te Imam Ebu Hamid el Gazalit, Allah paste meshire mbi te dhe mbi ne. Amin amin amin.

والحمد لله رب العالمين

Me respekt

Prof.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

31.08.2020

Doha -Qatar